



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:205334
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05457590

C.nr.1929/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – **Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, me gjyqtaren Njomëza Berisha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditëses F.O. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av.B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, me datë 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet se padia e paditëses F.O. nga Prizreni, me numër C.nr.1929/21, në këtë çështje kontestimore, është **TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësja F.O. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

I autorizuari i paditëses av.B.M. nga Prizreni me parashtresën e datës 13.02.2024, ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë.

Gjykata lidhur me këtë parashtresë ka njoftuar palën e paditur këtu Kompaninë e Sigurimeve “Siguria”, që në afat prej 7 ditësh, nga marrja e njoftimit të deklarohet lidhur me veprimin procedural të palës paditëse. I njëjti njoftimin e ka pranuar me dt.23.02.2024, ky fakt vërtetohet nga konstatimi në fletkthesë. Edhe pse ka kaluar ky afat i dhënë nga gjykata pala e paditur nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural, konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Me Nenin 261 par. 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Numri i lëndës: 2021:205334
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05457590

Në këtë drejtim duke marrë parasysh bazën ligjore të lartcituuar gjykata erdhi në përfundim se padia e paditëses F.O. kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria”, duhet të konstatohet e tërhequr, e në rastin konkret e paditura nuk është deklaruar fare lidhur me për tërheqjen e padisë, andaj konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Për arsyet e dhëna si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:205334, 15.03.2024

G j y q t a r e
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.